

GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË
P Nr. 215/07
16 SHKURT 2010

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË, në trupin gjykues i përbërë nga Gjykatësja e EULEX-it Hajnalka Veronika Karpati si Kryetare e Trupit Gjykues, dhe Gjykatësit e EULEX-it Klaus Jung dhe Nikolay Entchev si anëtarë të trupit Gjykues, me pjesëmarrjen e Tara Khan-it bashkëpunëtorë juridike si Procesmbajtëse, në veprën penale kundër;

E. H., i akuzuar, sipas Aktakuzës së Prokurores Publike të Qarkut PP. Nr. 169/2007 e datuar dhe regjistruar në Zyrën e regjistrimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë më 10 shtator 2007, me veprat penal në vijim;

- **Mbajtja në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve**, në kundërshtim me Nenin 328, Paragrafi (2) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës ("KPPK")
- **Vrasje e Rëndë**, në kundërshtim me Nenin 147, Pika 9 të KPPK-së.

Pas mbajtjes së séancës dëgjimore publike më 21, 28 janar, 04 dhe 16 shkurt 2010, të gjitha në praninë e të akuzuarit **E. H.**, Avokatit tij Mbrojtës R. K., Prokurores Publike të EULEX-it Maria Bamieh, Palët e Dëmtuara **S. B.** (në seancat dëgjimore më 21 dhe 28 janar 2010) dhe **B. H.**

Pas shqyrtimit të Trupit Gjykues dhe të votimi të mbajtur më 16 shkurt 2010, në pajtim me Nenin 392, Paragrafi (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës ("KPPK"), e shpalli publikisht dhe në praninë e të Akuzuarit, Avokatit të tij Mbrojtës, Prokurores Publike të EULEX-it dhe të Palës së Dëmtuar **B. H.**, këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari **E. H.**, i biri i ... dhe ..., i lindur më ..., në fshatin ..., Komuna e ..., shqiptar kosovar, adresa e fundit e njohur në fshatin ..., Komuna e ..., punëtor, i ve me ...fëmijë të moshës madhore, të gjendjes së mesme ekonomike, i padënuar më herët, në paraburgim që nga 31 maji 2007.

SHPALLET FAJTOR

- **sepse** më 31 maj 2007 rreth orës 11.30, në shtëpinë e tij në Fshatin Kllodernicë – Skenderaj, i akuzuari, për shkak të xhelozisë dhe për të penguar gruan e tij që ta braktisë, e vrau gruan e tij **R. H.** duke e përdorur armën M-48, prodhim Jugosllav, të kalibrit 7,92X57mm, me numrin serik 167535, duke shtënë nga afërsia, së paku tre herë në drejtim të viktimës e duke e goditur atë në gjoks dhe në pjesën e abdomenit. **R. H.** vdiq në vendin e ngjarjes për shkak të plagëve të shkaktuara.

Me këtë, i akuzuari **E. H.** ka kryer dhe është përgjegjës për veprën penale të

A, Vrasjes së Rëndë, në kundërshtim me Nenin 147, Pika 9 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK).

- **sepse**, i akuzuari ishte në posedim të armës M-48, prodhim Jugosllav, me numrin serik 167535, pa lejen e vlefshme të autorizimit dhe ka përdorur të njëjtën armë për të vra gruan e tij më 31 maj 2007.

Me këtë, i akuzuari **E.H.** ka kryer dhe është përgjegjës për veprën penale të

B, Mbajtja në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve, në kundërshtim me Nenin 328, Paragrafi (2) të KPPK-së

PRANDAJ, i akuzuari **E. H.**

DËNOHET

- me 14 /katërbëdhjetë/ vjet burg për veprën penale të Vrasjes së Rëndë /Akuza A)
- me 2 /dy/ vjet burg për veprën penale të Mbajtjes në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve /Akuza B/.

Dënimi unik është përcaktuar në 15 (pesëmbëdhjetë) vjet burg, në pajtim me nenin 71, Paragrafi (1) dhe Paragrafi (2), Pika (2) të KPPK-së.

Koha e kaluar në paraburgim që nga 31 maji 2007 do të llogaritet në pajtim me nenin 73, Paragrafi (1) të KPPK-së.

Arma, M-48, e prodhimit Jugosllav, e kalibrit 7,92x57mm, me numrin serik 167535 konfiskohet në pajtim me nenin 60, Paragrafi (1) dhe Nenit 328, Paragrafi (5) të KPPK-së.

I akuzuari do të kompensojë shpenzimet e procedure penale në pajtim me Nenin 102, Paragrafi (1) të KPPK-së me përjashtim të shpenzimeve të interpretimit dhe të përkthimit. Një aktvendim i veçantë lidhur me lartësinë e shpenzimeve gjyqësore do të lëshohet nga ana e gjyqit atëherë kur te sigurohen të dhënat e gjegjëse në pajtim me Nenin 100, paragrafi (2) të KPPK-së.

Kërkesat pronësore juridike të palëve të dëmtuara do t'i referohen procedurës civile në pajtim me Nenin 112, paragrafi (2) të KPPK-së.

ARSYETIMI

A-Historiku i Procedurës

Aktakuza PP nr. 169/2007 e datës 10 shtator 2007 dhe e ngritur nga Shyqyri Sylja Prokuror Publik i Qarkut e akuzon të akuzuarin me Vrasje të Rëndë në kundërshtim me nenin 147, Paragrafi (9) të KPPK-së dhe Mbajtje në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve në kundërshtim me Nenin 328 Paragrafi (2) të KPPK-së. Aktakuza është konfirmuar më 20 nëntor 2007 dhe Shqyrtimi Gjyqësor ka filluar më 12 shkurt 2008.

Mirëpo, për shkak të zhvendosjes me dhunë të Stafit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë nga gjykata në mars të viti 2008, Shqyrtimi Gjyqësor është penguar pas disa seancave dhe nuk ka mundur të kryhet. Kryeprokurori i EULEX-it e mori lëndën më 17 gusht 2009 dhe ia dorëzoi atë Maria Bamieh-Prokurore e Publike e Qarkut, e cila kërkoi që gjykatësit e EULEX-it të marrin lëndën në shqyrtim.

Gjykatësit e EULEX-it e morën lëndën përsipër më 14 tetor 2009 dhe e mbajtën Shqyrtimin Gjyqësor më 21 dhe 28 janar 2010 dhe më 4 e 16 shkurt 2010. Fjalët përfundimtare nga Prokurorja Maria Bamieh dhe Avokati Mbrojtës **R. K.** si dhe deklarata e dhënë nga Pala e dëmtuar **B. H.**, u dëgjuan më 16 shkurt 2010. Aktgjykimi u paraqit gojarisht në të njëjtën ditë.

B-Kompetenca e Gjykatës

Sipas nenit 23, Pika 1) i) të KPPK-së, Gjykatat e Qarkut janë kompetente që të shqyrtojnë veprat penale që përfshijnë akuzat për të cilat ligji lejon shqiptimin e dënimit penal prej

së paku pesë (5) vjet burg. Në pajtim me Nenin 27 Paragrafi (1) të KPPK-së, kompetenca territoriale i takon gjykatës në qarkun e së cilës konsiderohet të jetë kryer vepra penale.

Ashtu siç është thënë këtu më lart, akuza për Vrasje të Rëndë në pajtim me Nenin 147 Pika 9 të KPPK-së lejon imponimin e dënimit me burg së paku prej 10 vjetëve. Më tutje, aktakuza në këtë rast pohon se i akuzuari i ka kryer veprat në fshatin ... të Komunës së Skenderajt.

Prandaj, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë është organ kompetent gjyqësor për të shqyrtuar këtë procedurë penale.

Më 14 tetor 2009 Presidentja e Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it ua caktoi lëndën Gjykatësve të EULEX-it në bazë të Neneve 3.3 dhe 3.5 të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it.

Prandaj, Gjykatësit e EULEX-it të caktuar në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë janë kompetentë për të shqyrtuar këtë lëndë penale. Trupi Gjykues ishte përbërë prej Gjykatëses Penaliste të EULEX-it Hajnalka Veronika Karpati si Kryetare e Trupit Gjykues dhe Gjykatësve të EULEX-it Klaus Jung dhe Nikolay Entchev si anëtarë të Trupit Gjykues. Që të tre gjykatësit janë të caktuar në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë.

C-Përmbledhja e Provave të Prezantuara

Gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor janë dëgjuar dëshmitarët në vijim:

- (1) **S. B.** – Palë e Dëmtuar, 28 janar 2010
- (2) **B. H.** – Palë e Dëmtuar, 28 janar 2010
- (3) **S. H.** – Vëllai i të Akuzuarit, 02 shkurt 2010

Gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor janë lexuar deklaratat e dëshmitarëve në vijim:

- (4) **L. H.** – Palë e Dëmtuar, deklarata e 03 shtatorit 2007, e lexuar më 04 shkurt 2010
- (5) **P. H.** – Palë e Dëmtuar, deklarata e 03 shtatorit 2007, e lexuar më 04 shkurt 2010

Më 04 shkurt 2010 janë lexuar dokumentet e poshtëshënuara në procesverbal:

- (6) Raporti i Policisë 2007-BI-161 i datës 31 maj 2007 në faqen 90 të dosjes së Prokurorisë.
- (7) Raporti i Policisë nga Toger **M. K.** i datës 31 maj 2007 në faqen 110 të dosjes së Prokurorisë duke e përjashtuar pjesën e raportit ku i Akuzuari jap informata lidhur me veprën penale të kryer.

- (8) Raporti nga Ekzaminimi i Vendit të Ngjarjes nga **K. O.** dhe **F. G.** të datës 31 maj 2007 në faqen 105 të dosjes së Prokurorisë.
- (10) "Lista e Provave" Raporti i Policisë nga **K. O.** i datës 14.08.2007 në faqen 151 të dosjes së Prokurorisë.
- (11) Raporti i Forenzikës mbi Identifikim nga **N. D.** i datës 31 maj 2007 në faqen 136 të dosjes së Prokurorisë.
- (12) Letra e shkruar nga i Akuzuari në faqen 25 të dosjes së Prokurorisë.
- (13) Letra e shkruar nga i Akuzuari e datës 17 janar 2008 në faqen 60 të dosjes së Prokurorisë.
- (14) ZPZHML Raporti i Mjekut Ligjor MA07-129 i datës 20 qershor 2007 në faqen 167 të dosjes së Prokurorisë.
- (15) Raporti i Forenzikës nga Fejsal Lutfiu në faqen 158 të dosjes së Prokurorisë.
- (16) Fotografi të Forenzikës në faqet 185-196 të dosjes së Prokurorisë.

Gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor më 04 shkurt 2010, i akuzuari nuk ka dhënë deklaratë por iu është përgjigjur pyetjeve të Prokurores, Palës së Dëmtuar **Besa Hasanit** dhe anëtarëve të Trupit Gjykues.

D-Vlerësimi i Provave të Prezantuara

1. Konstatimet Faktike

Pas prezantimit të provave gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor, Gjykata i konsideron provat në vijim si të vërtetuara:

Gjatë një periudhe prej ca vjetëve para ngjarjes kritike, i Akuzuari **E. H.** dhe gruaja e tij, viktima **R. H.**, ishin duke kaluar nëpër vështirësi martesore të cilat e kishin burim dyshimin e fortë, por të pa bazë të Akuzuarit se gruaja e tij kishte një marrëdhënie të papërshtatshme me **I. H.**. I Akuzuari edhe insistoi që gruaja e tij të betohej për të vërtetuar besnikërinë e saj, ceremonia e betimit ka ndodhur para disa anëtarëve të familjes duke e përfshirë këtu edhe vajzën e tyre të moshës madhore **B. H.** dhe të vëllain e viktimës **S. B.**. Përkundër kësaj ceremonie, dhe mohimit të vazhdueshëm të viktimës për ndonjë keqbërje, dyshimi dhe xhelozia e të Akuzuarit vazhdoi me këmbëngulje, duke shkaktuar probleme të mëtutjeshme në martesë të cilat shpien deri të vrasja.

Më 31 maj 2007 rreth orës 11.30, i Akuzuari dhe gruaja e tij ishin vetëm në shtëpinë e tyre në fshatin ..., Komuna e Skenderajt. I Akuzuari kishte pirë së paku një birrë. Ai nuk kishte shkuar në punë por kishte qëndruar në shtëpi. Pasi kishin pirë kafe, i Akuzuari vuri re se gruaja e tij ishte duke i mbledhur ca rroba dhe ai e pyeti se çka ishte duke bërë. Ajo u përgjigj se donte të shkonte në Skenderaj. Ata pastaj e patën një përçarje verbale se a kishte ajo nevojë për lejen e të Akuzuarit për të shkuar në Skenderaj. I Akuzuari u hidhërua dhe për të penguar gruan e tij nga shkuarja si dhe për shkak të xhelozisë, ai e mori pushkën e tij M-48, e prodhimit Jugosllav, e kalibrit 7,92X57mm me numrin serik

167535 dhe e qëllloi gruan e tij **R. H.**, së paku tre herë nga afërsia duke e vrarë atë në vend .

2. Provat që i vërtetojnë konstatimet faktike

Nuk kishte dëshmitarë okularë lidhur me ngjarjet që kishin ndodhur në mëngjesin e 31 majit 2007. Mirëpo, Gjykata ishte në gjendje që të sqaronte gjendjen faktike në mënyrë të mjaftueshme në bazë të dëshmive konfirmuese të dëshmitarëve, provave materiale në shkresat e lëndës, raportit nga vendi i ngjarjes, foto dokumentacionit, raportit balistik, raportit të autopsisë si dhe dëshmisë së vetë të Akuzuarit.

a. Përmbledhja e Dëshmisë së të Akuzuarit

Gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor më 04 shkurt 2010, i Akuzuari vullnetarisht iu përgjigj pyetjeve të Prokurores, të palës së Dëmtuar **B. H.** dhe të Trupit Gjykues. Sipas fjalëve të të Akuzuarit, ngjarjet që kishin shpënë deri te vrasja e gruas së tij ishin si në vijim:

I Akuzuari ishte vetëm me gruan e tij në shtëpi në mëngjesin e 31 majit 2007. Pasi kishin pirë kafe bashkë, i Akuzuari vuri re se gruaja e tij ishte duke i mbledhur ca rroba rreth divanit. I Akuzuari e pyeti se çka ishte duke bërë dhe ajo iu përgjigj duke thënë se ishte duke i përgatitur rrobat sepse dëshironte që të shkonte në Skenderaj. I Akuzuari pastaj i tha gruas së tij se ajo do të duhej të kishte lejen e tij për të shkuar në Skenderaj sepse ai ishte burri i saj. Ajo refuzoi të kërkonte leje prej tij, dhe vazhdoi duke thënë se nuk kishte nevojë të kërkonte leje prej tij sepse ai ishte një plak i molisur i cili kishte vdekur edhe pse ishte ende gjallë. Për shkak të këtij “sulmi verbal” nga gruaja e tij, i Akuzuari u nxeh dhe e “humbi kontrollin”¹. Ai e mori pushkën e tij, e cila ishte në të njëjtën dhomë dhe shtiu në të.

Të Akuzuarit nuk i kujtoheshin detajet e të shtënave aktuale, duke përfshirë se sa herë kishte shtënë me pushkë. Mirëpo, raporti i autopsisë konfirmon se **R. H.** ishte qëlluar së paku tre herë nga afërsia me një armë të llojit të pushkës, se çdo plagosje nga plumbi ishte fatale dhe se viktima do të vdiste menjëherë nga këto plagë.²

Lidhur me bindjen e tij të një marrëdhënieje të vazhdueshme në mes të viktimit dhe **I. H.**, i Akuzuari dëshmoi se ai “kurrë” nuk kishte dyshuar në gruan e tij se ajo kishte një marrëdhënie³ dhe “kurrë nuk e kishte akuzuar atë” për një gjë të tillë⁴. Në pyetjen se pse ishte dashur që viktima t’i nënshtrohej një ceremonie të tillë të betimit para familjes, i

¹ Procesverbali i seancës së shqyrtimit gjyqësor më 04.02.2010, f. 19, 22 dhe 23

² ZPZHML Raporti i Mjekut Ligjor MA07-129 i datës 20 qershor 2007, f. 7.

³ Procesverbali i Shqyrtimit Gjyqësor më 04. 02. 2007, f. 13 & 16.

⁴ Procesverbali i Shqyrtimit Gjyqësor më 04. 02. 2007, f. 19.

Akuzuari deklaroi se gruaja e tij kishte menduar se ai dyshonte në të lidhur me diçka, por ai nuk kishte dyshuar në të.⁵

I Akuzuari po ashtu dëshmoi se ai kurrë nuk e kishte keqtrajtuar viktimën fizikisht gjatë martesës së tyre dhe se kishin kaluar shumë mirë.⁶ Ai më tutje dëshmoi se viktima gëzonte një liri të madhe në martesën e tyre – dhe se “ajo ka mundur të shkojë kudo që ka dëshiruar”.⁷

b. Pranimi i Pjesshëm i Dëshmisë së të Akuzuarit

Lidhur me mëngjesin e 31 majit 2007, Gjykata e pranoi dëshminë e të Akuzuarit si të besueshme vetëm deri në atë masë kur ai i përshkroi rrethanat objektive faktike që kishin ndodhur në mëngjesin kritik. Për shembull, Gjykata pranon se viktima ka qenë duke i mbledhur rrobat me qëllim të përgatitjes për t'u larguar nga shtëpia për të shkuar në Skenderaj, ashtu siç ishte deklaruar nga i Akuzuari dhe mbështetur me fotografi nga vendi i ngjarjes.

Mirëpo, lidhur me trajtimin subjektiv të viktimës nga ana e Akuzuarit gjatë martesës së tyre, Gjykata konstatoi se deklarata e të Akuzuarit nuk ishte e besueshme. Në veçanti, Gjykata e refuzon mohimin e të Akuzuarit se e kishte keqtrajtuar viktimën gjatë një periudhe të gjatë në vitet para vrasjes si dhe ato lidhur me dyshimet dhe xhelozitë e tij për gjoja një marrëdhënie ndërmjet viktimës dhe **I. H.** Këto mohime kundërshtohen drejtpërsëdrejti nga dëshmitë e fëmijëve si dhe nga i vëllai i viktimës – dhe në një moment edhe nga vet i Akuzuari – dhe Gjykata ua dha besimin këtyre dëshmimeve të dëshmitarëve (siç janë përmendur më poshtë).

Paraqet një vëmendje të posaçme pohimi i të Akuzuarit se viktima ishte në gjendje të gëzonte një liri të lëvizjes në martesën e tyre. Ai deklaroi se viktima ishte e lirë që të vinte dhe të shkonte nga shtëpia. Mirëpo, kjo është në kundërshtim të drejtpërdrejt me shpjegimin e tij se përçarja e tyre në mëngjesin kritik kishte buruar nga dëshira e viktimës që të shkonte nga shtëpia pa lejen e tij. Deklaratat tjera të dëshmitarëve konfirmojnë se viktimës i nevojitej leja nga i Akuzuari për të shkuar diku dhe nuk i lejohej që të shkonte diku jashtë shtëpisë vetëm.

c. Dëshmitë e Dëshmitarëve të Besueshëm

Gjersa dëshmitë e fëmijëve të të Akuzuarit dhe të viktimës – **B. H.**, **L. H.** dhe **P. H.** – sikurse edhe të vëllait të viktimës – **S. B.** – nuk mund të ofrojnë ndonjë detal konkret lidhur me ngjarjen kritike të 31 majit 2007, ato megjithatë ofrojnë një dëshmi të qartë të abuzimit afatgjatë të viktimës **R. H.** gjatë martesës së tyre, frika e viktimës nga i

⁵ Procesverbali i Shqyrtimit Gjyqësor më 04. 02. 2007, f. 17.

⁶ Procesverbali i Shqyrtimit Gjyqësor më 04. 02. 2007, f. 22.

⁷ Procesverbali i Shqyrtimit Gjyqësor më 04. 02. 2007, ff. 13, 18-19.

Akuzuari dhe dyshimet dhe akuzat këmbëngulëse të të Akuzuarit për një aferë në mes të viktimës dhe **I. H.** Këto dëshmi janë të qëndrueshme dhe të besueshme, dhe e vërtetojnë njëra tjetrën.

S. B. dëshmoi se i Akuzuari e kishte informuar atë se **I. H.** kishte qenë vetëm me gruan e tij (viktimën **R. H.**) dhe se dyshonte në ata dy. Përafërsisht dy muaj pas kësaj bisede, i Akuzuari e kishte detyruar viktimën të betohej në një ceremoni para **S. B.** dhe anëtarëve tjerë të familjes në kokën e djalit dhe në kokën e **S. B.** se nuk ka pasur asnjë marrëdhënie me **I. H.** Viktima më vonë i kishte treguar **S. B.** se përkundër ceremonisë së betimit, i Akuzuari kishte vazhduar të dyshonte në të se kishte një marrëdhënie me **I. H.** dhe se ai kurrë nuk ishte pajtuar me te.

S. B. po ashtu dëshmoi se me një rast viktima ishte larguar nga shtëpia e saj për disa ditë dhe kishte shkuar te e bija e saj, **B. H.**, për të qëndruar atje, për shkak të një përjarjeje me të Akuzuarin lidhur me **I. H.** dhe sepse ajo frikohej nga i Akuzuari. Ajo i kishte marrë dy fëmijët e saj, **P. H.** dhe **L. H.**, sepse kishte frikë se i Akuzuari do t'ua bënte ndonjë të keqe atyre. Pas kësaj, viktima “nuk kishte guxuar” të kthehej vet në shtëpi.⁸ Mirëpo, anëtarët e familjes intervenuan dhe e kthyen atë në shtëpinë e saj më të Akuzuarin, pasi e kishte njoftuar **S. B.** se ajo frikohej nga i Akuzuari sepse ai e kishte kërcënuar dhe më parë e kishte përdhunuar atë seksualisht me një gyp të ujit dhe shishe të birrës.⁹ Viktima i kishte treguar **S. B.** se pas këtij përdhunimi, ajo kurrë nuk e kishte ndier veten mirë në prani të Akuzuarit.

Sipas **S. B.**, vrasja kishte ndodhur më se një vit pas ceremonisë së betimit dhe nja pesë deri gjashtë muaj pasi që viktima e kishte braktisur shtëpinë dhe kishte qëndruar disa ditë te **B. H.**

B. H. dëshmoi para Gjykatës më 28 janar 2010. Sipas dëshmisë së saj, problemet në martesën e prindërve të saj të cilat e kanë shpënë deri të vrasja kishin filluar rreth viteve 2003/2004. I Akuzuari pinte dhe shkaktonte një presion të madh mbi viktimën, e cila gjë sipas **B. H.** kishte shkaktuar që e ëma e saj të humbiste vetëdijen dhe të alivanosej. Viktima duhej të kërkonte leje nga i Akuzuari që të ikte nga shtëpia për çdo arsye. Kur i Akuzuari e lejonte që të shkonte diku, asaj nuk i lejohej që të shkonte vetëm por duhej të shoqërohej ose nga i Akuzuari ose nga njëri prej fëmijëve. Përveç kësaj i Akuzuari e akuzonte gruan e tij gjithmonë se ajo kishte një marrëdhënie me **I. H.**, dhe kjo vazhdoi edhe pasi që viktima i ishte nënshtruar ceremonisë së betimit.

B. H. po ashtu dëshmoi lidhur me sjelljen e dhunshme të të Akuzuarit ndaj fëmijëve. Me një rast ai e hodhi një sëpatë në drejtim të bijës së tij Lumturije Hasanit, dhe me një rast tjetër e goditi **B. H.** dy apo tre herë në kokë me një llambë me bateri dhe kërcënoi se “do të shkonte dhe do të merrte pushkën”.¹⁰

⁸ Procesverbali i Shqyrtimit Gjyqësor më 28 janar 2010, f.6.

⁹ Procesverbali i Shqyrtimit Gjyqësor më 28 janar 2010, f. 6 & 10; Deklarata e Selim Bullakut e dhënë Prokurorës Publike më 03.09.2007.

¹⁰ Procesverbali i Shqyrtimit Gjyqësor më 28 janar 2010, f. 12.

B. H. e vërtetoi dëshminë e **S. B.** lidhur me incidentin kur viktimja ishte larguar nga shtëpia bashkë me fëmijët e saj **P. H.** dhe **L. H.** dhe kishte qëndruar te Besa Hasani nga frika që kishte prej të Akuzuarit. Gjatë qëndrimit të viktimës, ajo e kishte informuar **B. H.** për herë të parë lidhur me mënyrat e ndryshme të abuzimit nga ana e të Akuzuarit – duke përfshirë rrahjen, lidhjen e një litari rreth qafës së saj, duke ia drejtuar pushkën në qafë, duke e akuzuar atë se kinse kishte një marrëdhënie me **I. H.** dhe duke e përdhunuar seksualisht me një shishe të birrës.¹¹ Viktimja i ka treguar **B. H.** se deri sa i Akuzuari ishte duke e përdhunuar me një shishe të birrës ai kishte thënë “Ndoshta kjo shishe të mjafton sepse unë nuk jam aq i madh si **I. H.**, a e ka ai kaq të madh?”¹²

B. H. po ashtu konfirmoi se pasi që familja e kishte kthyer viktimën në shtëpi me të Akuzuarin, dhe ata kinse u pajtuan, ata vazhduan të kenë probleme dhe përjarje.

Sipas deklaratës së **P. H.**,¹³ gjatë 2-3 vjetëve të fundit, prindërit e tij janë përklarë shpesh dhe ai është zgjuar shpesh nga gjumi nga kërcënimet verbale të të Akuzuarit të drejtuara gruas së tij. Me një rast **P. H.** ishte dëshmitar kur i Akuzuari e kërcënoi viktimën me një armë. **B. H.** deklaroi se ishin tri arsye për përklarje – pija e të Akuzuarit, çështje të të hollave, dhe dyshimi i të Akuzuarit se gruaja e tij e kishte një marrëdhënie me **I. H.** Kur familja u mundu të bindte të Akuzuarin se viktimja nuk kishte ndonjë marrëdhënie me **I. H.**, ai i akuzoi ata se ishin në anën viktimës dhe kërcënoi se do t’i vriste edhe ata po ashtu. Për këtë arsye, Patrioti dhe motra e tij shkuan që të qëndronin te **B. H.** në Skenderaj.

Deklarata e **L. H.**¹⁴ përputhet me **B. H.** dhe **P. H.** në çdo aspekt. **L. H.** deklaroi se problemet martesore të prindërve të saj kishin filluar në vitin 2003. Babai i saj, i Akuzuari, kishte bërë presion ndaj nënës së saj dhe e kishte kërcënuar. Këto kërcënime ishin rezultat i tri arsyeve: alkoolit, parave, dhe bindjes së të Akuzuarit se viktimja kishte një marrëdhënie me **I. H.** Lumturia konfirmoi se ajo, nëna e saj dhe **P. H.** kishin shkuar te **B. H.** për të qëndruar te ajo disa ditë, sepse i Akuzuari i kishte kërcënuar ata dhe nëna e tyre kishte frikë të kthehej në shtëpi. Deklarata e **L. H.** po ashtu konfirmon se i Akuzuari e kishte detyruar viktimën që të betohej në praninë e anëtarëve të familjes se ajo nuk kishte marrëdhënie me **I. H.** Mirëpo, përkundër betimit, i Akuzuari vazhdoi të dyshonte dhe ta keqtrajtonte gruan e tij. Në fakt, **L. H.** e ndërpreu shkollimin e saj për të qëndruar në shtëpi dhe për ta mbrojtur nënën e saj nga i Akuzuari.

d. Deklarata e S. H.

¹¹ Procesverbali i Shqyrtimit Gjyqësor më 28 janar 2010, f. 12-13.

¹² Minutes of the Main Trial hearing on 28 January 2010, p. 13.

¹³ Minutes of hearing of witness before District Public Prosecutors Office, 03 September 2007, p. 80 of Prosecution bundle.

¹⁴ Minutes of hearing of witness before District Public Prosecutors Office, 03 September 2007, p. 75-76 of Prosecution bundle.

Gjykata po ashtu e dëgjoi deklaratën e të vëllait të të Akuzuarit, **S. H.**, më 04 shkurt 2010. Deklarata e **S. H.** nuk ofroi ndonjë informatë shtesë për provat. Së pari, **S. H.** nuk ka qenë dëshmitar i veprës penale, dhe ka kuptuar për vrasjen e viktimës nëpërmes vajzës së tij. Së dyti, dëshmitari tha se kur vajza e tij kishte shkuar në shtëpinë e të Akuzuarit në ditën kritike, i Akuzuari i kishte thënë se ai e kishte vra gruan e tij “për arsye të tija” pa dhënë ndonjë specifikë tjetër.¹⁵ Së fundi, edhe pse dëshmitari dhe familja e tij jetonin në afërsi të shtëpisë së të Akuzuarit dhe të viktimës dhe edhe pse dëshmitari deklaroi se se ai ishte afër familjes, Gjykata konstatoi se dëshmia e tij nuk ishte e besueshme për shkak të mungesës së informatave lidhur me problemet martesore në mes të Akuzuarit dhe gruas se tij. **S. H.** deklaroi se nuk kishte asnjë njohuri lidhur me bregat e të Akuzuarit lidhur me **I. H.**, përkundër faktit që dyshimi ishte i njohur në familjen e të Akuzuarit si dhe te vëllai i viktimës **S. B.**. Ai po ashtu dëshmoi se arsyeja e vetme që dinte se viktima kishte qëndruar në shtëpinë e **B. H.** ishte sepse viktima ka qenë e sëmure, kurse deklaratat e **S. B.**, **B. H.**, **P. H.** dhe **L. H.** konstatuan se ata të tre ishin larguar nga shtëpia pas kërcënimeve nga i Akuzuari dhe se viktima kishte frikë të kthehej në shtëpi.

Deklarata e vetme e **S. H.** e cila është vërtetuar nga dëshmitarët tjerë është ajo se i Akuzuari pinte shumë alkool dhe se “ai ishte si uji për të”.¹⁶

e. Konkluzionet e Gjykatës

Në bazë të të gjitha deklaratave të dëshmitarëve, si dhe deklaratave të të Akuzuarit, Gjykata mbërriti në këto konkluzione.

I akuzuari e kishte një histori të tërë të keqtrajtimit dhe të abuzimit të gruas së tij gjatë viteve që i kishin parapri vrasjes. Viktima gëzonte pak liri, dhe mund të dilte nga shtëpia pas marrjes së lejes nga i Akuzuari dhe atë vetëm e shoqëruar. Viktima ishte abuzuar fizikisht nga i Akuzuari, duke përfshirë përdhunimin seksual me një shishe të birrës dhe të një gypi të ujit nga ana e të Akuzuarit. Gjykata mbërriti deri te ky konkluzion i fundit në bazë të konstatimit të saj dëshmitë e **B. H.** dhe **S. B.** ishin të besueshme, dhe se ishte joreale se viktima, e përshkruar si një grua e thjeshtë dhe nënë e shtëpisë nga një fshat i vogël, do të trillonte tregime të tilla të cilat do të ishin jashtëzakonisht të turpshme dhe poshtëruese për te.

I Akuzuari ishte pushtuar me dyshimin e tij se viktima dhe **I. H.** kishin një marrëdhënie. Ky dyshim ka qenë plotësisht i pabazë dhe jashtë çdo logjike. Siç është theksuar nga Avokati Mbrojtës në fjalimin e tij përmbyllës, **I. H.** dhe viktima kanë qenë bashkë vetëm disa minuta gjatë një kohe kur kishte shumë mysafirë në shtëpi. Mirëpo, fakti se një dyshim i tillë ka qenë joreal apo joracional nuk e kundërshton konkluzionin se i Akuzuari e ushqente atë në mendjen e tij. Në fakt, duket se i Akuzuari kishte një besim të fortë dhe këmbëngulës se marrëdhënia ekzistonte, dhe nuk mund të lëkundej nga ky besim

¹⁵ Minutes of the Main Trial Hearing on 04 February 2010, p. 4 & 5.

¹⁶ Procesverbali i seancës së Shqyrtimit Gjyqësor më 04 shkurt 2010, f. 4.

shkatërrues me një ceremoni të rregullt të betimit apo garancitë e anëtarëve të familjes së tij të ngushtë.

Më 31 maj 2007, i Akuzuari e vrau gruan e tij për dy arsye; Për shkak të xhelozisë që e kishte burimin në dyshimet e tij këmbëngulëse se ajo kishte një marrëdhënie me **I. H.**, dhe për të penguar atë që të largohej nga shtëpia për të shkuar në Skenderaj.

Gjykata tërheq vëmendjen se gjatë gjykimit nuk ishte konstatuar aq sa duhet se a kishte ndërmend viktimën të shkonte në Skenderaj për një vizitë të shkurtër, ose ajo kishte ndërmend të linte burrin e saj. I Akuzuari dëshmoi se viktimën kishte ndërmend që të dytë të shkonin në Skenderaj. Mirëpo, Gjykata dëgjoi dëshmi të bollshme lidhur me abuzimin e viktimës nga ana e të Akuzuarit, dhe nuk mundet me e përjashtua mundësinë se viktimën ishte procesin e largimit nga shtëpia e saj martesore, ashtu siç kishte vepruar më parë nga frika nga i Akuzuari. Mirëpo, qëllimi i saktë i viktimës lidhur me këtë pikë nuk është i nevojshëm për të shpallë dënimin në këtë gjykim.

E. Kualifikimi Ligjor

1. Ligji i Aplikueshëm

Trupi Gjykes iu referua Kodit të Përkohëm Penal të Kosovës, meqë ai ishte kodi penal në fuqi kur u kryen veprat penale. Aplikimi i ligjit të ri, Kodi Penal i Kosovës nuk do të ishte më i favorshëm për të Akuzuarin. Sipas ligjit, në një rast të tillë, ligji në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale do të aplikohet. Lidhur me kodin procedural, Trupi Gjykes i referohet Kodit të Procedurës Penale të Kosovës si ligj në fuqi kur gjykohet vepra penale.

2. Vrasja e Rëndë kundër Vrasjes së Kryer në Gjendje të Afektit Mendor

Nuk ka asnjë dyshim lidhur me fajësinë e të Akuzuarit për kryerjen e vrasjes, pasi që ai pranoi para Trupit Gjykes se e kishte vra gruan e tij. Çështja e ngritur ka të bëjë me faktin nëse ai ishte një akt i Vrasjes së Rëndë ashtu siç akuzohet nga Prokuroria, ose Vrasje e Kryer në Gjendje të Afektit Mendor siç pohohej nga Avokati Mbrojtës.

Gjykata konstatoi se vepra e kryer nga ana e të Akuzuarit përbën Vrasje të Rëndë sipas kualifikimit ligjor të pikës 9 të Nenit 147 të KPPK-së – një vrasje ku autori i krimit e privon personin tjetër nga jeta e tij/saj për shkak të hakmarrjes së paskrupullt ose motive tjera të ulëta. Në rastin në fjalë, Gjykata konstatoi se i Akuzuari kishte zhvilluar një obsesion me idenë se gruaja e tij dhe **I. H.** ishin në një marrëdhënie. Prova tregon se kjo bindje ishte e thellë dhe kryeneçe. Edhe pas detyrimit të gruas së tij që të betohej në një ceremoni të betimit para familjes, i Akuzuari nuk mundi të lironte veten nga ndjenja e xhelozisë që e kishte lidhur me aferën në fjalë. Për këtë arsye, çifti përjetoi probleme martesore të cilat vazhduan edhe pas ceremonisë së betimit, dhe arriti kulmin në ditën kritike kur viktimën tentoi të braktiste shtëpinë dhe i Akuzuari e vrau atë. Ai ishte i shtyrë të bënte vrasjen nga motivi i ulët i xhelozisë, të cilat ishin të ndërthurura në mënyrë të pandashme me dëshirën e tij për të penguar gruan e tij nga braktisja.

Gjykata refuzon argumentin e Avokatit Mbrojtës se vepra bie nën kualifikimin e Vrasjes së Kryer në Gjendje të Afektit Mendor në pajtim me Nenin 148 të KPPK-së. Neni 148 është i aplikueshëm kur autori i vrasjes është sjellë jo me fajin e tij në një gjendje të shokut të rëndë i shkaktuar nga ndonjë sulm, keqtrajtim apo një ofendim i rëndë nga viktima e vrarë. Në rastin aktual, elementet e kërkuara nuk janë plotësuar. Së pari, nuk kishte ndonjë provë se viktima e kishte sulmuar apo keqtrajtuar të Akuzuarin. Më saktë, viktima kishte përjetuar abuzim nga ana e të Akuzuarit me vite të tëra. Përveç kësaj, kinse deklarata e saj se ajo i kishte thënë të Akuzuarit në mëngjesin kritik se ai ishte i molisur, një plak për lejen e të cilit nuk ka pasur nevojë, nuk ngrihet deri në shkallën e një “sulmi” ashtu siç pohohet nga i Akuzuari. As vendimi i saj për të braktisur shtëpinë pa lejen e tij nuk përbënte ndonjë ofendim të rëndë. Së dyti, mënyra se si është kryer vepra ajo nuk e konstaton se i Akuzuari ka qenë në gjendje të shokut të rëndë. I Akuzuari e përdori pushkën e cila duhej të mbushej me dorë në mes të çdo qitjeje, dhe e kishte goditur viktimën tre herë. Prandaj, ai është dashur të ketë pasur vetëdijen mendore si dhe vetëkontrollin për të mbushur dhe shtënë me pushkë në mes të çdo qitjeje.

3. Përgjegjësia Penale e të Akuzuarit

Gjykata konstatoi se i Akuzuari nuk lirohet nga përgjegjësia penale për shkak të ndonjë çrregullimi apo sëmundjeje mendore të përkohshme apo permanente. Ekspertiza psikiatrike e bërë në pajtim me Urdhrin e Gjykatës ofron një përgjigje të qartë se i Akuzuari nuk mund të konsiderohet mendërisht i paaftë ose që vuan nga kapaciteti i zvogëluar mendor siç është paraparë nga Neni 12 i KPPK-së. Ekspertët Mjekësor konstatuan se në kohën e kryerjes së veprës penale, i Akuzuari nuk ka vuajtur nga ndonjë sëmundje apo çrregullim mendor i përkohshëm apo permanent, dhe që kapaciteti i tij për të kontrolluar vetën dhe për të kuptuar pasojat e veprave të tija ishte “zvogëluar por jo në mënyrë thelbësore”.¹⁷ Neni 12, Paragrafi 2 i KPPK-së kërkon që për një kapacitet mendor të zvogëluar, aftësia e vepruesit për të kuptuar ose kontrolluar veprimet e veta apo lëshimet ajo duhet të jetë “dukshëm e zvogëluar”.

F-Dënimi

Kur shqiptohet sanksioni penal, Gjykata duhet të ketë parasysh si qëllimin e përgjithshëm të dënimit – që do të thotë t’u japë fund aktiviteteve të rrezikshme shoqërore duke i frenuar të tjerët nga kryerja e veprave të ngjashme penale – dhe qëllimin specifik, i cili është të pengojë kriminelin nga kryerja e sërishme e veprës penale. Në rastin konkret, Trupi Gjykues erdhi në përfundim se vetëm me zbatimin e dënimit të shqiptuar me burg mund të arrihet qëllimi i dyfishtë i lartpërmendur. Vrasja me gjakftohtësi e gruas nga ana e të Akuzuarit pas një kohe të gjatë të abuzimit ishte një vepër e rëndë penale, dënimi i

¹⁷ Raporti mbi Ekzaminimin e Gjendjes mendore të Enver Hasanit nga Mjekët Fahri Drevinja, Nazife Sylejmani, dhe Nada Morina, Departamenti I Psikiatrisë, Qendra Klinike Universitare e Kosovës, 21 prill 2008.

shqiptuar duhet t'i dërgojë një porosi të fortë shoqërisë se një trajtim i tillë i grave nuk mund të tolerohet dhe duhet të dënohet në proporcion me veprën e kryer penale.

Në caktimin e kohëzgjatjes së dënimit, Gjykata duhet të vlerësojë të gjithë faktorët lehtësues dhe rëndues, në pajtim me Nenin 64, paragrafi (1) të KPPK-së.

Gjykata i mori në konsideratë si rrethana lehtësuese moshën e shtyrë të të Akuzuarit, faktin se ai nuk kishte një të kaluar kriminale, gjendjen e tij shëndetësore dhe se ai pjesërisht i kishte pranuar veprat penale – e kishte pranuar fajësinë për vrasje dhe armëmbajtjen e paligjshme dhe përdorimin e armës. Gjykata mori në konsideratë si rrethana rënduese abuzimin e gjatë që i Akuzuari ia kishte bërë gruas së tij, moshën e shtyrë të viktimës, dhe faktin se ajo ishte nënë e shtatë fëmijëve. Po ashtu, një rrethanë speciale rënduese ishte mënyra me të cilën ishte kryer vepra penale – me gjak të ftoftë, me stil të ekzekutimit nga afërsia, me një armë e cila kërkonte mbushjen me dorë para se secili nga tre plumbat të ishte shtënë në trupin e viktimës.

Për veprën penale të Vrasjes së Rëndë, në kundërshtim me nenin 147, Pika 9 të KPPK-së, ligji parasheh një dënim me burg prej minimum dhjetë (10) vjetëve. Duke e zbatuar Nenin e cituar dhe duke i konsideruar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, Gjykata ia caktoi dënimin prej katërmëdhjetë (14) vjetëve për Vrasje të Rëndë.

Për veprën penale të Mbajtjes në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të paautorizuar të Armëve në kundërshtim me nenin 328, Paragrafi (2) të KPPK-së, ligji parasheh një dënim të gjobës apo të burgut prej një deri në tetë vjet. Gjykata ka caktuar dënimin prej dy (2) vjetëve me burg për këtë veprë penale.

Pasi që i Akuzuari ka kryer dy vepra penale, në pajtim me rregullat e llogaritjes të një dënimi të përbashkët, dënimi unik duhet të jetë më i lartë se çdo dënim individual por jo aq i lartë sa shuma e dënimeve të parapara. Prandaj, Gjykata caktoi një dënim unik prej pesëmbëdhjetë (15) vjetëve me burg.

I Akuzuari gjendet në paraburgim që nga 31 maji 2007. Kjo periudhë do të llogaritet në dënimin e caktuar në pajtim me Nenin 73, Paragrafi (1) të KPPK-së.

G-Sendet e Konfiskuara

Arma e përdorur për kryerjen e veprave penale – një pushkë M-48, e prodhimit Jugosllav, e kalibrit 7,92X57mm, me numrin serik 167535 – me anën e kësaj konfiskohet në pajtim me Nenin 60, Paragrafi (1) dhe neni 328, Paragrafi (5) të KPPK-së.

H-Shpenzimet

I Akuzuari do të kompensojë shpenzimet e procedurës penale në pajtim me nenin 102, Paragrafi (1) të KPPK-së me përjashtim të shpenzimeve të interpretimit dhe përkthimit.

Gjykata do të lëshojë një aktvendim të posaçëm lidhur me shumën e shpenzimeve atëherë kur të dhënat e tilla të sigurohen në pajtim me nenin 100, Paragrafi (2) të KPPK-së.

I-Kërkesa për Kompensim

Më 16 shkurt 2010, **B. H.**, si palë e dëmtuar, paraqiti kërkesën pronëso-ro-juridike në emër të vet dhe po ashtu në emër të vëllait e motrave të saja. Kërkesa është paraqitur gojarisht në ditën e fundit të seancës së Shqyrtimit Gjyqësor, pas fjalëve përfundimtare të Prokurores Publike. Kjo do të kërkonte të bëheshin verifikime të mëtutjeshme për të konstatuar se a është dhe deri në cilin nivel është e justifikueshme kërkesa në fjalë, e cila do të vononte procedurën penale në mënyrë të rëndësishme. Prandaj, Trupi Gjykues i udhëzoi Palët e Dëmtuara që të paraqesin një kërkesë pronëso-ro-juridike në një proces gjyqësor në gjykatën për çështje civile.

Gjykata e Qarkut në Mitrovicë P. nr. 134/08¹⁸

E përgatitur në gjuhën angleze, gjuhë e autorizuar.

Procesmbajtësja

Kryetarja e Trupit Gjykues

Tara Khan

Hajnalka Veronika Karpati

Këshillë Juridike:

Personat e autorizuar mund të paraqesin ankesën në formë të shkruar kundër këtij aktvendimi në Gjykatën Supreme të Kosovës nëpërmes Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve prej datës kur kopja e aktgjykimit është pranuar, në pajtim me Nenin 398, paragrafi (1) të KPPK-së.

¹⁸ Numri i saktë i lëndës është P.Nr.215/07